

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylja, në lëndën penale kundër të pandehurit B. Z, për shkak të veprës penale, vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2008/16, të datës 04.11.2016, të cilën e përfaqësonte prokurorja e shtetit Bahtie Ademi, pas mbajtes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, më 10.05.2017, publikisht shpalli, ndërsa më 17.05.2017, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B. Z, nga babai E dhe nëna M, e lindur U, i lindur më..., në fshatin D, tani me vendbanim në fshatin M, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i martuar, babë i tre (3) fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij,

ë s h t ë f a j t o r

S e p s e prej datës së pavërtetuar e deri më datën 08.08.2016, në kohë të papërcaktuar, në lokalitetin e tij në fshatin..., në mënyrë të vazhdueshme dhe të paautorizuar ka përfituar nga shërbimi komunal – rrjeti i shpërndarjes së rrymës së..., në atë mënyrë që e ka hapur kapakun, i ka zhvendosur daljet dhe të njejtat i kishte vendosur në hyrje dhe në këtë mënyrë ka shpenzuar energji elektrike pa u regjistruar ajo askund si shpenzim, me ç'rast..., e ka dëmtuar për shumën e të hollave në vlerë prej 2.479.99 eurove.

Me çka ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit, i

SHQIPTON,

- Dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri, brenda periudhës verifikuese prej dy (2) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit nuk kryen vepër tjetër penale, dhe

- Dënim me gjobë në shumën prej 200€ (dyqind) Euro i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një (1) ditë burgim me njëzet (20) Euro gjobë.

Detyrohet i pandehuri që ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej njëzet (20) euro, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

E dëmtuara..., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjiçan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit, Blerim Zeqiri, për shkak të veprës penale, vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën kanë prezentuar prokurorja e shtetit Bahtie Ademi, i pandehuri B. Z.s i dhe përfaqësuesja e të dëmtuarës.....

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri....., e ka kuptuar aktakuzën, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPRK-së, pas këtij njoftimi, i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale, vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të aktakuzës.

Prokurorja e shtetit Bahtie Ademi në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar : Duke u bazuar në faktin se i pandehuri....., e ka pranuar veprën penale e cila i vëhet në barrë sipas kësaj aktakuze, dhe se ky pranim i fajësisë është bërë pas njoftimit të gjyqtarit lëndor, lidhur me pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, fakte këto në bazë të të cilave vërtetohet në mënyrë të pa kontestueshme se i njëjti ka kryer veprën penale, ashtu siq është përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, andaj mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që t'i merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës.....

I pandehurinë fjalën e vet përfundimtare ka deklaruar: e ndjej vetën fajtor për kryerjen e kësaj vepre, pendohem për të njëjtën, i kërkoj falje të dëmtuarës....., i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre, andaj kërkoj nga gjykata që t'më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri, e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet e prezentuara nga prokurorja e shtetit.

Aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri Blerim Zeqiri, në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Andaj të pandehurin në fjalë e shpalli fajtorë dhe i shqiptoj dënimin kumulativ si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit me burim të kushtgëzuar për dy vite, dhe dënimin me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së.

Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjykata pati parasysh faktin se i njejt i ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, është penduar për të njejtën si dhe premtimin se ne të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre, dëmin e shkaktuar të dëmtuarës KEDS-it – Distrikti në Gjilan, si dhe gjendjen e mirë ekonomike të ytij.

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe se ky dënim do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 parag.1 nën parag. 2 .6 të KPPRK-së.

E dëmtuarakonform nenit 463 të KPPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm.
P.nr.1228/16,më 17.05.2017**

Sekretarja juridike,
Rafete Syla,d.v.

Gjyqtari
Islam Thaçi,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

